



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 487/2 Prot.

Tiranë, më 22 / 05 / 2020

V E N D I M

Nr. 51, Datë 22 / 05 / 2020

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 22, datë 25.03.2020, të paraqitur nga organizata: “Qendra për Advokim Social” kundër Këshillit të Ministrave, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “*gjendjes ekonomike dhe familjare*”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, subjekti ankues informon se: “*Nisur nga situata e vështirë në të cilën ndodhet Shqipëria nga përhapja e virusit COVID-19, organizata është informuar nga familjet e varfëra që gjatë 12 ditëve të karantinës në disa qytete të Shqipërisë nuk janë shpërndarë pako mjaftueshëm për familjet e varfëra për shërbimet bazë siç janë: ushqime, detergjend dhe medikamente. Nisur nga kjo situatë, familjet e varfëra, kryesisht të përfaqësuar nga komuniteti rom dhe egjiptian kanë reaguar duke u mobilizuar me njeri tjetrin, duke zhvilluar protesta në qytetet e tyre me thirrjen për t’iu siguruar ushqimi bazë nga ana e institucioneve, pasi situata e krijuar ka lënë këto familje në pamundësi për të kryer punën informale të përditshme siç është: mbledhja e mbetjeve të riciklueshme, tregëtimi i rrobave të përdorura, mbledhja e skrapit, etj. Këshilli i Ministrave ka miratuar Vendimin nr. 236, datë 19.03.2020 “Për marrjen e masave për ofrimin e asistencës në banesë ndaj shtresave në nevojë, në kushtet e epidemisë së shkaktuar nga COVID-19” por familjet të cilat sigurojnë të ardhurat përmes punës informale nuk e gjejnë veten të mbështetur në kategoritë e përcaktuara në këtë*

vendim, për rrjedhojë ata nuk mund të përfitojnë ndihma nga shërbimet e ofruara nga institucionet shtetërore. Nevojitet që pjesë të këtij vendimi të jenë dhe familjet e varfëra, të cilët janë punëkërkues të papunë, që për arsye objektive nuk kanë arritur që t'iu sigurohet një punë nga institucionet shtetërore. Aktualisht këto familje ushtrojnë informalisht aktivitetet e sipërpërmendura”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, që familjet të cilat sigurojnë të ardhurat nga aktivitetet informale të lartpërmendura dhe që janë punëkërkues të papunë afatgjatë, të konsiderohen si shtresa në nevojë dhe të përfshihen në VKM-në nr. 236, datë 19.03.2020.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Neni 7 i LMD-së, në pikën 1 të tij, parashikon se: *“Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.*

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Në bazë të nenit 3/9 të Ligjit nr. 10221/2010, “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, “organizatat me interesa legjitime”, janë ato organizata të cilat janë të regjistruara në Republikën e Shqipërisë dhe kanë si objekt të deklaruar të veprimtarisë së tyre mbrojtjen e të drejtave të njeriut, ose u ofrojnë ndihmë viktimave të diskriminimit.

Sa më sipër, Komisioneri konstaton se subjekti ankues “Qendra për Advokim Social”, legjitimohet për të paraqitur ankesë përpara Komisionerit, si një organizatë me interesa legjitime që pretendon diskriminim për një grup personash. Në këto kushte, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

Gjatë shqyrtimit të kësaj anekese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga Ligji nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

- Me shkresën nr. 453/2, datë 31.03.2020, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga Këshilli i Ministrave për ankesën e bërë nga Qendra për Advokim Social. Nga ana e Këshillit të Ministrave nuk ka pasur një përgjigje mbi kërkesën e bërë.

Me e-mail-et datë 27.03.2020 dhe 30.03.2020 i është kërkuar informacion dhe dokumentacion subjektit ankues lidhur me identifikimin e familjeve që nuk kishin përfituar ndihma si nga institucionet qendrore ashtu dhe nga ato vendore.

Subjekti ankues me e-mail-et datë 27.03.2020 dhe 03.04.2020 ka dërguar informacionin mbi problematikën e trajtimit të familjeve në nevojë të bërë publik nga media si dhe ka dërguar një listë të personave që nuk kishin marrë ndihma ushqimore nga Bashkia Tiranë në zonën e Kombinatit, Yzberishtit dhe Lagjes nr. 10.

Me shkresën nr. 506, datë 07.04.2020, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi i ka rekomanduar Këshillit të Ministrave, si më poshtë:

Marrjen e masave, për përfshirjen në pikën 4 të VKM-së nr. 236, datë 19.03.2020 “Për marrjen e masave për ofrimin e asistencës në banesë ndaj shtresave në nevojë, në kushtet e epidemisë së shkaktuar nga COVID-19”, gjatë periudhës së fatkeqësisë natyrore, sipas përmbajtjes së këtij Rekomandimi, me qëllim:

1. Përfshirjen e kategorisë së personave që janë punëkërkues të papunë, të cilët nuk kanë qenë më parë të punësuar dhe për pasojë nuk kanë kontribuar në skemën e sigurimit shoqëror sipas nenit 53 të Ligjit 7703 datë 11/05/1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
2. Krijimin e lehtësive për personat që nuk janë deri aktualisht të regjistruar si punëkërkues të papunë, me qëllim krijimin e mundësisë për përfshirjen e kësaj kategorie gjithashtu, si subjekte përfituese të asistencës , në zbatim të VKM Nr. 236, datë 19.03.2020.

Gjatë zhvillimit të procedurave hetimore, Komisioneri, mori dijeni se Këshilli i Ministrave me Vendimin nr. 341, datë 23.04.2020¹ “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 305, datë 16.04.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të ndihmës financiare për të punësuarit aktualë dhe punonjësit e larguar nga puna si pasojë e COVID-19”, në pikën 8 ka vendosur: *“Dhënie ndihme financiare prej 16.000 (gjashtëmbëdhjetë mijë) lekësh për aplikuesit e ndihmës ekonomike, të cilët rezultojnë aplikues që nga muaji korrik 2019 e deri në muajin prill 2020, të cilët nuk kanë përfituar ndihmë ekonomike dhe, aktualisht, nuk përfitojnë as nga fondi 6 për qind akorduar bashkive, përveç*

¹ Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 75, datë 27.04.2020.

rasteve që janë përjashtuar nga skema e ndihmës ekonomike, sipas nenit 15, të ligjit nr. 57/2015, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”.”.

Subjekti ankues, me e-mail-in datë 15.05.2020, ka informuar Komisionerin se me miratimin e VKM-së nr. 341, datë 23.04.2020 e konsideron si të përmbushur objektin e ankesës së paraqitur pranë Komisionerit.

Për sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vlerëson, se kërkesa e Qendrës për Advokim Social, është plotësuar, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin është nisur ky hetim, në drejtim të zgjerimit të numrit të subjekteve që hyjnë në kategorinë e shtresave në nevojë dhe trajtimit të tyre me ndihmë financiare, gjatë periudhës së fatkesësisë natyrore të shkaktuar nga COVID-19.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 33, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” dhe nenit 90, pika 2 dhe 3 të Kodit të Procedurave Administrative, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative të nisur, lidhur me shqyrtimin e ankesës së Qendrës për Advokim Social, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin është iniciuar procedura hetimore.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONER

Robert GAJDA